REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Nr.i Prot. 7067-2/23
Njësia org. 51-02
Nr. i Faqeve -04-
Data: 04.09.24
PRISHTINË / A

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria – Vlada - Government***

***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës***
***Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture***
***Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure***

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara /Office of the General Secretary*

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 21.08.2024 |
| **REFERENC-Ë:** | 23/7067/MMPHI |
| **PËR/ZA/TO:** | "ADEA GROUP " Sh.p.k., Gjilan<br>Përpunimi dhe ambalazhimi i ujit të zakonshëm dhe ujit mineral, Gumnishtë, Gjilan. |
| **CC:** | Komisioni për Leje Mjedisore |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | |
| **NGA/OD/FROM:** | Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Vendim për ndërprerje të procedurës administrative |

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka kontrolluar dokumentacionin për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit, "ADEA GROUP " Sh.p.k., Gjilan, me nr.prot. 23/7067/MMPHI, me veprimtarinë: Fabrikë për ambalazhimin e ujit natyral, Gumishtë, Gjilan.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

1. Vendimi për **ndërprerje të procedurës administrative** për operatorin, "ADEA GROUP " Sh.p.k., Gjilan, Përpunimi dhe ambalazhimi i ujit të zakonshëm dhe ujit

Me respekt!


Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/

Nr.: 23/7067/MMPHI
Datë: 21.08.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

## VENDIM

Operatori, "ADEA GROUP " Sh.p.k., Gjilan, i **ndërpritet procedura administrative** për veprimtarinë: Përpunimi dhe ambalazhimi i ujit të zakonshëm dhe ujit mineral, Gumnishtë, Gjilan, në ngastrën, nr. 4662 zona kadastrale, Poneshë, Gjilan.


Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/

## A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për Leje Mjedisore nga operatori, "ADEA GROUP " Sh.p.k., Gjilan, me veprimtarinë: Përpunimi dhe ambalazhimi i ujit të zakonshëm dhe ujit mineral, Gumnishtë, Gjilan, në ngastrën e nr. 4662, zona kadastrale, Poneshë, Gjilan. Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për leje Mjedisore ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si në vijim:

- Lejet ujore për shfrytëzim;
- Lejet ujore për shkarkim.

Komisioni për Leje Mjedisore ne takimin e mbajtur të datës: 21.08.2024, konstatoi se operatori "ADEA GROUP " Sh.p.k., Gjilan, me veprimtarinë: Përpunimi dhe ambalazhimi i ujit të zakonshëm dhe ujit mineral, Gumnishtë, Gjilan, nuk i plotëson kriteret e parapara për vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore, pasi qe nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur me lartë ne afatin kohorë të përcaktuar në nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **mbyll procedurën administrative,** në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

**Shpjegim për palën:** Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike**: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.



Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/

Izedin Bytyqi

______________________

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Gjilanë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.

ADEA GROUP
Përfundim i procedures



Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/